



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i kuvendit-

01Nr.60/01-5450/20
Kaçanik, 26.02.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja I-r (**Parë**) e Rregullt e Komitetit për Komunitete për vitin 2020, mbajtur me datë: 26 Shkurt 2020. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në Zyrën e Nënkyrytarit të Komunës, me fillim pune në ora 14:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin të gjithë 7 anëtarët: Lirije Luta-PDK, Kaltrina Tafili-LVV, Nazife Krasniqi-LDK, Hajredin Luta-AAK, Elmihane Krasniqi-Malsiu-HANDIKOS, Shemsedin Abazi nga KMLDNJ dhe Naim Hysa nga Kryqi i Kuq.

Mbledhjen e kryesoi Lirije Luta, Kryesuese e Komitetit për Komunitete.
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për Punë të Kuvendit të Komunës.

zpj.Lirije Luta, Fillimisht përshëndes të pranishmit dhe hapi mbledhjen e I-r(Parë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2020, data 26 Shkurt, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e katërt(4) e Komitetit për Komunitete e vitit 2019;
2. Diskutim për Raportin e Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019;
3. Gjendja e vaksinimit sezonal dhe barnatores në QKMF; dhe
4. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Komitetit për Komunitete e,

APROVOJ

Redin e punës, në përbërje prej 4 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;

Procesverbal i mbledhjes se IV-të(katërt) të rregullt të Komitetit për Komunitete i vitit 2019, u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se 4 të Komitetit për Komunitete të vitit 2019, të datës 09.12.2019 / Lënda : 01Nr.60/01-38274/19.

2. Diskutim për Raportin e Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019;

Lirija Luta, Raportin e punës e keni marrë. Unë jam munduar me i përfshirë të gjitha mbledhjet dhe aktivitetet tjera të këtij komiteti. Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

zpj. Nazife Krasniqi, Raporti është hartuar mirë më të gjitha mbledhjet dhe aktivitetet, ndërkaq ka ndonjë gabim teknik drejtshkrimore. Lidhur me aktivitetet tjera që po i zhvillojmë si komitet, është mirë paraprakisht të kemi një përbledhje të tyre, sepse po i harrojmë detajet kur po vijmë këtu.

zpj. Kaltrina Tafili, Unë nuk kam diçka në raport, rapporti është mirë i hartuar, në raport shihet së janë përfshirë të gjitha mbledhjet dhe aktivitetet tjera të cilat i kemi realizuar si komitet.

z. Hajredin Luta, Edhe unë pajtohem më parafolës të mi, rapporti është mirë i hartuar, unë nuk kam diçka me shtuar.

zpj. Lirije Luta, Atëherë a jeni që raporti t'i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komuniteti, **Raportin e Punës së vet për vitin 2019 ia adreson Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim**.

3. Gjendja e vaksinimit sezonal dhe barnatores në QKMF;

zpj. Lirije Luta, Në këtë pikë, drejtoresha nuk është këtu, megjithatë nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Shemsedin Abazi, Drejtoresha e DSHMS, Diana Reka, është ftuar në këtë takim, ndërkaq nuk iu ka përgjigjur ftesës sonë. Unë kujtoj se kjo mënyrë e mos përgjigjes së ftesës për me marrë pjesë në takime të komitetit për Komunitete nuk është në rregull nga drejtoresha. Nëse ka pasur ndonjë angazhim tjetër, atëherë ka pasur mundësi së paku me dërguar një përfaqësues të saj.

zpj. Nazife Krasniqi, Ne si Komitet i Komuniteteve edhe pse po i ftojmë drejtorët e drejtorive në mbledhje të këtij komiteti, ata nuk po i përgjigen ftesës sonë. Kjo është një injorim për ne si komitet, sepse edhe ky komitet është obligativ ashtu si KPF. Nëse në KPF ndiejnë obligim më marrë pjesë, atëherë edhe në këtë komitet duhet me marrë pjesë. Ne patëm një vizitë në QKMF lidhur me problemet të cilat i kanë për furnizim me barna, çështjen e barnatoreve etj. por ata të QKMF na thanë vetëm fjalë të mira dhe nuk paraqiten ndonjë vërejtje të organit të kësaj drejtorie. Lidhur me furnizimin e QKMF me barna esenciale, ata na thanë së me barna na furnizon komuna.

z. Hajredin Luta, Mungesa e drejtoreshës në këtë komitet, unë nuk e di se kujt duhet me iu drejtuar ne. Unë i kam pasur disa kërkesa, ndërkaq nuk kam kujt t'ia adresoj.

Të çështja e barnave esenciale, QKMF thotë së i furnizon komuna me këto barna, ndërkaq drejtoresha në rrjetet sociale thotë së është obligim i ministrisë e jo i DSHMS. QKMF ka bërë kërkesë për sigurimin e barnave esenciale të listuar gjithsej 136, ndërkaq janë furnizuar me 24 barna esenciale nga lista. Unë mendoj se dikush duhet të merr përgjegjësi për barnat tjera esenciale të cilat nuk kanë mundur me u siguruar. Tjetër, Komuna ndan çdo vit Grant specifik për shëndetësi. Më intereson të di, ku shkon ai grant, në infrastrukturë, në barna esenciale apo

diku tjetër. Barnatoret kujdestare nuk punojnë 24 orë, ndërkaq në anën tjetër thuhet se ka pasur dënim e shqiptuara nga inspektorët. Unë kisha pasur dëshirë me i pa ato dënim që janë shqiptuar nga inspektorët.

Tjetër: Barnatore brenda QKMF nuk lejohet, ndërkaq në anën tjetër si me vepruar pacienti i cili nuk ka mjet, kur dihet se barnat në QKMF mungojnë.

z. Naim Hysa, Lirije Luta, Të lista e barnave esenciale unë e kam shifrën nga 117 sa janë kërkuar, ndërkaq janë siguruar 42 lloje nga lista e barnave esenciale.

z. Kaltrina Tafili, Ne mundemi me i potencuar shifrat e raportuara të barnave esenciale se qysh na janë ofruar të dhënat nga organet relevante dhe dallimet në shifra.

z. Naim Hysa, Çështja e orarit të barnatoreve kujdestare u krijua si problem nga një shkrim në portalet sociale të një qytetari, ndërkaq unë nuk e di nëse është marrë ndonjë veprim nga DSHMS që me punuar me orar 24 orë ndonjë barnatore kujdestare. Nga ky komitet, duhet të dalim më Kërkeshë drejtuar DSHMS, që me marrë veprime të nevojshme për funksionimin e ndonjë barnatoreje kujdestare

z. Elmihane Malsiu, Të çështja e orarit të barnatoreve, komuna ka orar të përcaktuar, por barnatoret nuk iu përbahen atij orari. DSHMS na ka thënë se nuk ka staf të mjafsheshëm për me inspektuar orarin e barnatoreve. Ne si Komitet i Komuniteteve lidhur me këtë çështje është mirë të caktojmë një takim më barnatoret që funksionojnë në komunën tonë, drejtoreshën e DSHMS dhe inspektorët e komunës.

z. Lirije Luta, Unë kërkesat e juaja të cilat dolën nga kjo mbledhje, po i marr si rekomandim dhe të shikoj se çka mundemi më bërë në këtë drejtim që më mbajtur një takim lidhur me orarin e barnatoreve.

z. Kaltrina Tafili, Mospjesëmarrja e drejtorëve në mbledhje të këtij komiteti, me duket se është bërë e tepërt. Unë jam me i thirrur drejtorët me marrë pjesë në mbledhje, sepse ne nuk po kemi kujt me ia shprehur shqetësimet tona. Koronavirusi është duke u përhapur me të madhe në vendet tjera, ne duhet me qenë në gjendje gatishmërie për veprimet të cilat duhet me i marrë. Unë, çështjen e mospjesëmarrjes së drejtorëve të drejtorive në mbledhje të këtij komiteti, kam me ngritur mbledhje të Kuvendit të Komunës, dhe nëse vazhdojnë përsëri drejtorët që kanë pikë të caktuara mos me marrë pjesë në mbledhje, atëherë unë kam më ngritur Ankesë më shkrim. Unë kujtoj së ekzekutivi i komunës duhet t'i përgjigjet ftesave tona ashtu siç i përgjigjet KPF, sepse edhe ky komitet është komitet obligativ si KPF. Ne e pamë së nga QKMF janë listuar shumë barna esenciale për me u siguruar, ndërkaq në anën tjetër nga lista janë siguruar shumë pak barna esenciale. Kjo çështje kërkon zgjidhje, kur dihet së raste për kontroll mjekësore të qytetarëve të komunës ka në çdo kohë, ndërkaq barnatore brenda QKMF nuk ka.

z. Naim Hysa, Kur kërkesat tona ia adresojmë drejtpërsëdrejti organit përgjegjës në këtë rast drejtoreshës së DSHMS, atëherë edhe mënyra e komunikimit është më ndryshe edhe efektet mund të jenë më të mëdha.

Të Ndryshme:

znj. Lirije Luta, A ka kush diçka me paraqitur në këtë pikë ?

z. Naim Hysa, Shpreh shqetësimet e tija lidhur me rrahjen e grupeve të fëmijëve mes veti në ditën e premte. Rasti është lajmëruar në polici nga prindi i një fëmijë, mirëpo nuk janë marrë asnjë veprim nga ana e policisë deri në ditën e hënë kur prindi iu ka drejtuar përsëri organeve policore nga frika e prindit së gjendja mund të eskaloj në të ardhmen.

znj. Lirije Luta, Kjo çështje u ngrit sot në mbledhje të KKSB, por pak me ndryshe, ashtu që rasti paska shkuar për trajtim në emergjencë, por jo edhe me u lajmëruar në polici.

z. Naim Hysa, Prindi ka shkuar në polici së bashku me fëmijën me lajmëruar rastin, mirëpo nuk është intervenuar nga policia deri të hënën. Në Komunën e Kaçanikut ka dukuri të këqija që po ndodhin kohëve të fundit dhe nëse nuk merren masa nga policia, atëherë duhet llogaritur së çka mund të ndodhë në të ardhmen. Policia e Kosovës është në dijeni për raste të caktuara, por nuk i paraqesin të njëjtat.

znj. Elminhane Malsiu, Unë i shprehi shqetësimet e mia lidhur me disa dukuri që janë krijuar në SHF "Emin Duraku" përfshirë edhe bulizmin, të cilat çështje mund të marrin masa në të ardhmen. Unë e kam fëmijën në atë shkollë dhe nëse nuk merren veprime të nevojshme nga organet relevante për këtë çështje, atëherë nuk kam siguri me dërguar fëmijën tim në atë shkollë. Kjo shkollë duhet me pasur një bashkëpunim më të madh në mes arsimtarëve dhe prindërve të fëmijëve.

zpj. Lirija Luta, Unë e kam paraqitur çështjen e problemeve të shkollave në organet relevante të komunës, mirëpo ata nuk thonë se kemi të dhëna dhe gjendjen në shkolla e paraqesin jo të keqe, ndërkaq nuk i raportojnë dukuritë negative.

zpj. Elmihane Malsiu- Është mirë ne si komitet më marrë ndonjë hap me vërtetuar se a janë ato të dhëna të sakta, qoftë edhe përmes ndonjë ankete.

zpj. Kaltrina Tafili, Unë jam për me bërë diçka në këtë drejtim, sepse ekziston mundësia që dukuritë e tillë të fshehën. Ka pasur raste kur janë parë rastet, ndërkaq janë neglizhuar e nuk janë lajmëruar. Unë mendoj së organet relevante duhet marrin veprime edhe për këto raste edhe për çështjen e bulizmit në shkolla.

zpj. Elmihane Malsiu, E ngriti çështjen e Zyrave të Handikos. Kjo OJQ i ka në dispozicion dy zyre të lëshuara nga komuna në shtëpinë e kulturës, ndërkaq i ka shfrytëzuar edhe hapësirat tjera në këtë objekt për shkak të aktivitetave të saj. Çështja është së, tani DAK ka kërkuar që njëren zyre t'ia lirojmë një OJQ tjetër e cila është regjistruar tani. Unë kërkoj nga ju që, nëse e shihni të arsyeshme me bërë diçka rrëth zyrave të Handikos, kur dihet së kjo OJQ i ka 400 anëtarë, ndërkaq OJQ tjetër i ka për momentin vetëm 2 anëtarë.

z. Naim Hysa, Personi tjetër që zhvillon aktivitet në shtëpinë e kulturës, unë nuk e di pse nuk i bëjnë zgjedhje, kur dihet së ka zyre të lira që janë të mbyllura në objektin e shtëpisë së kulturës. Komuna nuk e ka obligim me iu bërë zgjedhje OJQ me dy persona. Handikos ka shumë aktivitete dhe kanë shumë pajisje, kështu që nevojat e saj për hapësirë është e madhe.

znj. Elmihane Malsiu, Paraqiti nevojat e Handikos për hapësirë për me zhvilluar aktivitete, ndërkaq theksoj së për kundër hapësirë Handikos në komunën tonë është shembull për aktivitetet që i ka zhvilluar. Unë shqetësimet e mia për hapësirë(zyre) i kam paraqitur edhe në DAK.

znj. Kaltrina Tafili, Më intereson të di, a keni bërë ndonjë kërkesë për ndonjë objekt tjetër që më iu lëshuar për aktivitete të Handikos.

znj. Elmihane Malsiu, Ferizaji ka bërë zgjidhje të objektit me pagesë për Handikos, ndërkaq edhe të ne ka mundësi me u bërë zgjidhje. Kemi bërë kërkesë për hapësirë për tokë. Unë mendoj së Çerdhja e vjetër e fëmijëve në Kaçanik i plotëson kushtet për aktivitete të Handikos. Shërbimet e handikos dita ditës kanë ardhur duke u decentralizuar, ndërkaq dikush ka me i kryer ato shërbime. Unë jam me ngritur çështjen e hapësirave të objekteve që janë pronë e komunës, kush i shfrytëzon, kush për kënd punon dhe çka përfiton.

znj. Lirije Luta, Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 15:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

M. Malsiu

Kryesuese e Komitetit

Lirije Luta

